



**DREJTIMET E ZHVILLIMIT**  
**Zhvilimi Njerëzor**

# Aftësi, jo thjesht Diploma

*Menaxhimi i arsimit për rezultate  
në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore*

Lars Sondergaard dhe Mamta Murthi  
me Dina Abu-Ghaida, Christian Bodewig dhe Jan Rutkowski



**BANKA BOTERORE**

## PËRMBLEDHJE

# Aftësi, jo thjesht diploma

*Menaxhimi i arsimit për rezultate në Evropën  
Lindore dhe Azinë Qendrore*

Lars Sondergaard dhe Mamta Murthi,  
me Dina Abu-Ghaida, Christian Bodewig, dhe Jan Rutkowski



BANKA BOTËRORE  
Washington, D.C.

Ky botim përmban një përmbledhje të librit të ardhshëm të Bankës Botërore *Aftësi, jo thjesht Diploma: Menaxhimi i arsimit për rezultate në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore*, së bashku me një listë të përmbajtjes së librit. Për të porositur kopje të plota të librit, të publikuar nga Banka Botërore, ju lutemi përdorni formularin në fund të këtij publikimi.

© 2012 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore  
1818 H Street NW  
Washington DC 20433  
Telefon: 202-473-1000  
Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Ky volum është një produkt i stafit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Bankës Botërore. Gjetjet, interpretimet, dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë detyrimisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore apo të qeverisë që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë punim. Kufijtë, ngjyrimet, emërtimet apo çdo informacion tjetër i shfaqur në secilën prej hartave të këtij punimi nuk nënkupton asnjë gjykim nga ana e Bankës Botërore për sa i përket statusit ligjor të çdo territori apo përkrahjen a pranimit e kufijve të tillë.

Të Drejta dhe Leje

Materiali në këtë publikim mbrohet nga copyright. Kopjimi dhe/apo transmetimi i pjesëve të këtij materiali apo i të gjithit pa leje mund të përbëjë shkeljen e ligjeve në fuqi. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore e inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe do të ishte e gatshme të lejonte, në kushte normale, riprodhimin e pjesëve të këtij punimi. Për të kërkuar leje për të fotokopjuar apo riprintuar pjesë të këtij punimi, ju lutemi dërgoni një kërkesë me informacionin e plotë në Copyright Clearance Center Inc., 222 Rosewood Drive, Danvers, MA 01923, SHBA; telefon: 978-750-8400; faks: 978-750-4470; Internet: [www.copyright.com](http://www.copyright.com).

Gjithë çështjet e tjera që kanë të bëjnë me të drejtat dhe licencat, duke përfshirë dhe të drejtat suplementare, duhet t'i adresohen Zyrës së Publikuesit, Banka Botërore, 1818 H Street NW, Uashington, DC 20433, USA; faks: 202-522-2422; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

Foto në kapak: Klasa që përfundon shkollën në 2007, Universiteti Alexandru Ion Cuza, Iași, Rumani, Ceremonia e diplomimit. © Mediafax Foto/Liviu Chirica.

# Përmbajtje

Parathënie për <i>Aftësi, jo thjesht diploma</i>	iv
Falënderime për <i>Aftësi, jo thjesht diploma</i>	vi
Shkurtime	vii
Përmbajtja e <i>Aftësi, jo thjesht diploma</i>	ix
<b>Përmbledhje</b>	<b>1</b>
Sfida e Aftësive	2
Pse janë aftësitë një problem emergjent nëse sistemet arsimore funksionojnë?	4
Fushat prioritare për veprim	6
Menaxhimi i sistemit arsimor për rezultate	8
Ndërtimi i bazave për sistemin e mësimdhënies për të rritur	12
Konkluzione	13
Shënime	14
<b>Figurat</b>	
Figura O.1 Analiza e kompetencës në lexim për nxënësit 15-vjeçarë në PISA 2009	3
Figura O.2 Shpërndarja e firmave në Rajonin ECA, të cilat e konsiderojnë mungesën e punëtorëve me aftësi si një pengesë “madhore” apo “tejet të rëndë”, 2008	4
Figura O.3 Raporti nxënës-mësues në rajonin ECA krahasuar me rajone të tjera gjatë 1990–2008	7
Figura O.4 Statusi i matjes dhe përdorimit të të dhënave mbi rezultatet e shkollimit të studentëve në Rajonin ECA, 2009	9

## Parathënie për *Aftësi, jo thjesht diploma*

Nuk është sekret fakti se një sistem i mirë arsimor qëndron në zemër të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i cilësisë dhe peshës së arsimit është tejet i vështirë për shkak se nuk ekziston një masë e vetme politike për ta arritur këtë synim në mënyrë efektive. Ky libër na ndihmon për të kuptuar më mirë mënyrën se si të përmirësojmë arsimin përmes ekzaminimit të eksperiencave të fundit të vendeve të Evropës Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik.

Të shndërruara në fabul për shkak të njëtrajshmërisë në akses dhe cilësisë së lartë të arsimit përpara 20 viteve, vendet e këtij rajoni janë përpjekur për të ruajtur reputacionin e tyre. Tre faktorë kryesorë kanë ndikuar në rënien e cilësisë dhe peshës. Së pari, një nga trashëgimitë e planifikimit të qëndëruar është se këto vende i kushtojnë shumë vëmendje matjes së inputeve në mësimdhënie – si për shembull numrit të shkollave dhe numrit të mësuesve – dhe jo aq shumë vëmendjes së rezultateve. Në këtë mënyrë ato kanë mbetur pas në zhvillimin e sistemeve për të aksesuar lëndën që studentët mësojnë dhe faktit nëse mësimi po i drejton këta të fundit drejt punësimit. Në këtë kuptim, sistemet e tyre arsimore veprojnë në errësirë, çka e bën politikbërjen veçanërisht të vështirë. Së dyti, menaxhimi i sistemit, gjithashtu një trashëgimi nga e kaluara, kufizon aftësinë e shkollave për të përmirësuar mësimdhënien për studentët, si dhe aftësinë e bashkive, të cilat mund të duan të diferencojnë programet e përziera për të arritur kërkesat e tregjeve lokale të punës. Gjithashtu, edhe me vlerësimet, këto vende kanë qenë të ngadalta në përkrahjen e reformave qeverisëse dhe atyre që lidhen me përgjegjësinë, të cilat janë tashmë pjesë e kuadrit të sistemeve arsimore në mbarë botën. Këto kufizime ndaj autonomisë dhe përgjegjshmërisë për rezultatet kanë reduktuar energjinë dhe incentivat për përmirësimin nga brenda sistemit, duke kontribuar në mungesën e aftësive. Në fakt ankesat e firmave për mungesën e aftësive të duhura për zhvillim janë rritur në shumicën e vendeve. Së fundmi, sistemet shpërndajnë vazhdimisht resurse aty ku ato nuk janë të nevojshme. Për shembull, rënia drastike në numrin e studentëve përgjatë 20 viteve të fundit nuk ka rezultuar në një rënie të shpenzimeve për numrin e klasave apo të mësuesve. Si pasojë, burimet janë lidhur gjithnjë e më shumë me ndërtesat dhe studentët, ndërkohë që mund të shpenzoheshin më efektivisht në aspekte të tjera. Shumë prej këtyre kufizimeve gjenden jo vetëm në shkolla, por dhe në arsimin e lartë dhe trajnimet.

Rezultati i këtyre kufizimeve është fakti se cilësia dhe pesha e arsimit në vendet e rajonit vihet shpeshherë në pyetje. Një numër i madh i studentëve që mbarojnë ciklin e ulët të shkollës dytësore kanë aftësi minimale të lexuari dhe numerike. Dështimi i tyre për të mësuar dhe gjërat më bazike pikaset me vonesë nga sistemet e vlerësimit, dhe as shkollat apo bashkitë nuk i kanë

mundësitë e nevojshme për të siguruar nxënien e bazave për të gjithë studentët. Sistemet gjithashtu përpiqen me dhënien e aftësive më të avancuara se ato bazike, për të cilat nevojiten në shumë mësues të mirëmotivuar e kualifikuar, por të cilët janë vështirë që të tërhiqen nga shkollat, duke pasur parasysh pagat e ulëta dhe mbipunësimin e zakonshëm. Dhe pa vizionin apo resurset për ta kthyer arsimin teknik dhe profesional në një zgjedhje atraktive për studentët—në të vërtetë, ky mbetet një nga nënsektorët më pak të reformuar në sistemin arsimor—cilësia ka rënë dhe studentët janë larguar nga kjo formë e arsimit, duke ndikuar me gjasë në mungesën e theksuar të aftësive teknike dhe profesionale që vërehet në këto vende.

Ky libër tregon se përmirësimi i cilësisë dhe peshës së arsimit kërkon ndryshime thelbësore në qasjen ndaj arsimit në vendet e rajonit. Si fillim, sistemet arsimore duhet të “ndejin dritat” dhe të marrin seriozisht masat mbi atë çka realisht studentët mësojnë sesa të merren me masat mbi inputet në proceset e arsimit që bazohen në hamëndësimin e nënkuptuar se shkollimi do të pasojë. Ky vlerësim duhet të informojë si mësimdhënien ashtu dhe politikëbërjen. Politikëbërësit duhet që gjithashtu të largohen nga kontrolli i inputeve dhe proceseve dhe në vend të kësaj të rrisin fokusin ndaj incentivave për të përmirësuar shkollimin e studentëve, si në shkolla ashtu dhe në arsimin e lartë. Dhe, së fundmi, në mënyrë që këto reforma të jenë të zbatueshme financiarisht, duhet që shpenzimet aktuale për arsimin të jenë shumë më efikase. Në veçanti, vendet e rajonit nuk mund të përballojnë mbajtjen e njërit prej niveleve më të ulëta të madhësisë së klasave në botë, ndërkohë që ngrohën dhe ndriçojnë godina gjysmë të boshatisura, kur burimet mund të përdoren në aspekte të tjera.

Mbetemi me besimin e sinqertë se ky libër do të stimulojë debate mbi përmirësimin e arsimit dhe trajnimit si në vendet e përmendura ashtu dhe në të gjithë botën, dhe si pasojë të nxisë veprime për të ndihmuar arritjen e prosperitetit për të gjithë.

Philippe Le Houerou  
Zëvendës President, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore  
Banka Botërore  
Washington, D.C.

## Falënderime për *Aftësi, jo thjesht diploma*

Ky studim u menaxhua nga Lars Sondergaard, i cili është autori i kapitujve 3 dhe 4, dhe Mamta Murthi, e cila është autore e Përmbledhjes dhe kapitullit 7. Jan Rutkowski është autor i kapitullit 1; Dina Abu-Ghaida është autore e kapitullit 2 me ndihmën e Christian Bodewig dhe Lars Sondergaard; Lars Sondergaard është autor i kapitullit 4 me ndihmën e Alex Usher; and Christian Bodewig është autor i kapitullit 6 me ndihmën e Sarojini Hirshleifer. Dina Abu-Ghaida bashkëmenaxhoi studimin në hapat e parë me Lars Sondergaard.

Libri ka lindur nga një program kërkimor rajonal i prezantuar dhe i mbështetur nga Zyra Kryesore Ekonomike për Evropën dhe Azinë Qendrore, dhe gjatë shkrimit të librit, dy kryeekonomistë ndihmuan për t'i dhënë formën përfundimtare: Pradeep Mitra dhe Indermit Gill. Autorët i janë mirënjohës që të dyve për udhëzimet dhe mbështetjen gjatë përgatitjes së këtij libri.

Ky libër është realizuar me kontributin domethënës të Michael Mertaugh, Alex Usher, Iveta Silova, Andras Benedek, Algerlynn Gill, Rostislav Kapelyushnikov, Hakan Ercan, Jerzy Wiśniewski, Maciej Jakubowski, Harry Anthony Patrinos, dhe Emilio Ernesto Porta. Gjithashtu duam të falënderojmë Juan Manuel Moreno dhe Nina Arnhold për rishikimin dhe komentet për disa nga draftet dhe për ndihmën në formimin e mesazheve kryesore të studimit, dhe Algerlynn Gill për asistencën e shkëlqyer kërkimore dhe të dhënat në disa nga kapitujt e librit. Gjithashtu Nadezhda Lepeshko dhe Carmen Laurente ndihmuan në përgatitjen e grafikëve dhe figurave për këtë dokument. Libri gjithashtu ka përfituar nga puna e përkryer redaktoriale e T Peggy McInerny dhe Patricia Carley. Larry Forgy ka mundësuar asistencë redaktoriale në kapitullin 1.

Gjithashtu kemi përfituar nga komentet e vlefshme të bashkëvlerësuesve: Richard Murnane, Amit Dar, Bernard Hugonnier, Halsey Rogers, dhe Manfred Wallenborn. Kemi përftuar të dhëna, komente dhe sugjerime nga shumë kolegë duke përfshirë Mohamed Ihsan Ajwad, Gordon Betcherman, Mary Canning, Isak Froumin, Sachiko Kataoka, Arvo Kuddo, Toby Linden, Lily Mulatu, Bojana Naceva, Reehana Rifat Raza, Alberto Rodriguez, Marcelo Selowski, Jan Sadlak, Jamil Salmi, Luis Crouch dhe shumë të tjerë. Çdo gabim që mbetet në këtë vëllim është përgjegjësi vetëm e autorëve.

## Shkurtime

BEEPS	Studimi për Klimën e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve (Business Environment and Enterprise Performance Survey)
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura (Commonwealth of Independent States)
ECA	Europe and Central Asia
EU	Bashkimi Evropian
EU10+1	Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe, dhe Sllovenia, plus Kroacia
GDP	Produkti i brendshëm bruto
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PIAAC	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Kompetencave tek të Rriturit (Program for International Assessment of Adult Competencies), OECD
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (Programme for International Student Assessment), OECD
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity)

Shkurtime të emrave të vendeve të përdorura në grafikë dhe tabela:

ALB	Shqipëria	KAZ	Kazakistani
ARM	Armenia	KGZ	Republika Kirgize
AUT	Austria	LTU	Lituania
AZE	Azerbajxhani	LUX	Luksemburgu
BEL	Belgjika	LVA	Letonia
BGR	Bullgaria	MDA	Moldavia
BIH	Bosnja dhe Hercegovina	MKD	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
BLR	Bjellorusia	MLT	Malta
CYP	Qipro	NLD	Holanda
CZE	Republika Çeke	NOR	Norvegjia
DEU	Gjermania	POL	Polonia
DNK	Danimarka	PRT	Portugalia
ESP	Spanja	ROU	Rumania
EST	Estonia	RUS	Federata Ruse
FIN	Finlanda	SRB	Serbia
FRA	Franca	SVK	Republika Sllovaqe
GBR	Mbretëria e Bashkuar	SVN	Sllovenia
GEO	Gjeorgjia	SWE	Suedia
GRC	Greqia	TJK	Taxhikistani
HRV	Kroacia	TKM	Turkmenistani
HUN	Hungaria	TUR	Turqia
IRL	Irlanda	UKR	Ukraina
ISL	Islanda	UZB	Uzbekistani
ITA	Italia		

*Shënim:* Këto kode trigershe janë pjesë e standardit 3166 për përfaqësimin e vendeve, të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO)

# Përmbajtja e *Aftësi, jo thjesht diploma*

*Parathënie*  
*Falënderime*  
*Shkurtime*

## Përmbledhje

Kapitulli 1	Kërkesa për aftësi në ECA
Kapitulli 2	Arsimi dhe oferta e aftësive në tregjet e ECA-s
Kapitulli 3	Zgjidhja e mangësive për aftësi në Rajonin e ECA-s: Një kuadër politikash
Kapitulli 4	Menaxhimi për rezultate në nivelin parauniversitar në arsim
Kapitulli 5	Menaxhimi për rezultate në sektorin e arsimit terciar
Kapitulli 6	Përmirësimi i mësimdhënies për të rritur në ECA
Kapitulli 7	Përmbledhje e zgjeruar: Rruga e reformave në arsim në Rajonin e ECA-s
	Referencat

## Përmbledhje

Vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) janë duke dalë aktualisht nga recensionimi më i thellë ekonomik që vuajtur ndonjëherë ndonjë rajon në zhvillim. Kushtet e post-krizës janë shumë të ndryshme nga ato të viteve paraardhëse. Burimet financiare janë më të kufizuara dhe më të kushtueshme, dhe rritja e eksporteve frenohet nga rritja potenciale më e ngadaltë në vendet e destinacionit. Ruajtja dhe mbështetja e rritjes në këtë kontekst kërkojnë reforma që rrisin konkurrueshmërinë dhe rrisin produktivitetin e punës. Reforma të tilla janë edhe më të rëndësishme nëse merren në konsideratë ulja e popullatës në moshe për të punuar në shumë nga vendet e rajonit.

Vitet e mëparshme të bumit ekonomik në rajonin ECA nxorën në pah pengesa domethënëse për rritjen, veçanërisht përkundrejt aftësive të forcës punëtore (Mitra et al. 2010). Në mënyrë paradoksale, për një rajon që ka arritje të larta dhe të vazhdueshme në arsim (e matur në bazë të numrit të viteve për shkollimin e plotësuar) dhe cilësi relativisht të lartë të arsimit për vitet e para të shkollimit, ekziston një mangësi e aftësive në punë çka konstatohet si një prej pengesave kryesore të zgjerimit të bizneseve. Ky raport kërkon t'i jap një përgjigje disa pyetjeve: Pse firmat që operojnë në rajonin ECA po ankohen gjithnjë e më shumë për mungesën e të diplomuarve me aftësitë e duhura? Çfarë mund të bëjnë vendet e ECA për t'i zvogëluar këto mangësi në aftësi?

Teksa tenton t'iu japë përgjigje këtyre pyetjeve, studimi përballet me një problem thelbësor: ekzistojnë të dhëna për numrin e studentëve që diplomohen (pra sa diploma janë lëshuar) në vendet ECA, por nga ana tjetër nuk ekzistojnë të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht mbi faktin nëse të diplomuarit në institucionet sekondare dhe terciare të arsimit (shumica e të cilëve furnizojnë tregun e punës në ECA) i kanë aftësitë dhe kompetencat e duhura për kërkesat e tregut.

Ky raport përdor një sërë burimesh të dhënash për të argumentuar se problemi i aftësive në rajonin ECA varet më shumë prej cilësisë dhe relevancës së arsimit të ofruar në vendet ECA sesa nga problemet që kanë të bëjnë me aksesin. Një nga argumentet kryesorë të studimit është fakti se ministritë e arsimit në këto vende, janë të penguar në disa mënyra për të menaxhuar në mënyrë efektive sektorin e arsimit dhe trajnimit. Tre pengesat kryesore dhe të ndërlydhura me njëra tjetrën ndaj përmirësimit të cilësisë dhe relevancës janë: mungesa e të dhënave sistematike mbi çështjet që lidhen me performancën në kuadër të përmirësimit/menaxhimit të aftësive (p.sh. sa po mësojnë studentët dhe nëse po punësohen pasi janë diplomuar), trashëgimia e planifikimit të qendëruar, dhe përdorimi i paefektshëm i burimeve.


Mungesa e të dhënave mbi shkollimin e studentëve dhe rezultatet në punësim, e bëjnë të vështirë për ministrinë e arsimit që të adresojë trashëgiminë e planifikimit qendror që vë theksin tek menaxhimi i qendëruar bazuar në inputet. Ministritë e arsimit në rajon vazhdojnë të mikro-menaxhojnë sektorin duke përdorur norma dhe rregulla të detajuara. Ky stil menaxhimi i orientuar drejt inputeve shpie drejt përdorimit të paefektshëm të burimeve dhe rezultateve në një sektor i ngurtë arsimor—jo tipi i sektorit fleksibël që i nevojitet ECA për të krijuar një forcë

punëtores të aftë dhe moderne. Ky raport ve në dukje mënyrën se si këto pengesa shfaqen dhe më pas prezanton disa mënyra për tejkalimin e tyre, duke u mbështetur në eksperiencën e vendeve të ECA që i kanë adresuar me sukses të tilla probleme, së bashku me eksperiencën ndërkombëtare. Rekomandimet janë dhënë në tri kapituj të ndryshëm për arsimin para-universitar, atë terciar, dhe arsimin për të rritur.

## Sfida e Aftësive

Rajoni i ECA-s ka pasur një sistem arsimor të mirë-konsideruar përpara tranzicionit. Edhe pse vitet e ndërmjetme kanë marrë diçka nga shkëlqimi i dikurshëm i këtij reputacioni, këto vende vazhdojnë të kenë arritje të domethënëse. Në këtë aspekt, regjistrimet mbeten të larta në të gjitha nivelet e arsimit. Trashëgimia komuniste mbetet veçanërisht e dukshme në vendet me të ardhura të pakëta në rajon, të cilat kanë nivelet më të larta të regjistrimit në botë për arsimin sekondar bazuar në nivelin e tyre të të ardhurave. Regjistrimet terciare, të cilat janë rritur ndjeshëm në dy dekadat e fundit, janë gjithashtu relative ndaj nivelit të të ardhurave, me përjashtimin e disa vendeve me të ardhura të ulëta të zonës së Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (CIS), si Azerbajxhani dhe Uzbekistani.

Rajoni i ECA-s është relativisht i suksesshëm jo vetëm në kuadër të nivelit të regjistrimeve, por edhe për sa i përket mësimdhënies cilësore në vitet e para. Veçanërisht, në testet ndërkombëtare që matin kompetencën e studentëve në arsimin primar dhe klasat e para të arsimit sekondar, studentët e shumë prej (por jo të gjithë) vendeve ECA kanë rezultate më të mira se shokët e tyre në vende me nivel të njëjtë të ardhurash (shih figurën O.1). Për shembull, studentët në Estoni, ku Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për individ ishte 21,644\$<sup>2</sup> në 2008, i tejkaluan të ngjashmit e tyre në Danimarkë, Suedi, Islandë, dhe Austri—ku të ardhurat për individ janë dy herë më të larta—në pjesën matematike të Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar për Studentët (PISA). Gjithsesi peisazhi më i gjerë i cilësisë të arsimit brenda rajonit ECA është më i larmishëm, duke qenë se vende si Bullgaria, Rumania, Mali i Zi, Azerbajxhani dhe Republika Kirgize kanë studentë (në klasat fillore) që performojnë më dobët krahasuar me mesataren e vendeve me të njëjtin nivel të ardhurash.


**Figura O.1 Analiza e kompetencës në lexim për nxënësit 15-vjeçarë në PISA 2009**

*Burimi:* Kalkulimet e Data Bazës PISA 2009 dhe të stafit të Bankës Botërore bazuar në Data Bazë e Indikatorëve të Zhvillimit Botëror.

*Shënim:* PISA = Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve. Figura tregon një linjë regresioni që përfaqëson pikët e vendit për leximin sipas PISA bazuar vetëm në PBB për frymë, në krahasim me mesataren e pikëve të leximit të OECD (vija horizontale) dhe PBB për frymë në 2008. Shih “Shkurtime” për emrat e vendeve.

Paçka këtyre arritjeve pozitive të sistemeve arsimore në ECA, Studimi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) - Bankës Botërore për Klimën e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve (BEEPS) tregon se perceptimi i bizneseve në ECA për sa i përket mungesës së aftësive ndryshoi gramatikisht diku në vitin 2005.<sup>3</sup> Në vitin 2008 mungesa e krahut të aftë të punës ishte kthyer në vështirësinë e dytë më shumë të raportuar në të gjitha vendet e ECA për sa i përket rritjes ekonomike të bizneseve në BEEPS, e tejkaluar vetëm nga ankimet për nivelin e taksave. (shih figurën O.2). Mesatarisht, 30 përqind e bizneseve e konsideronin arsimimin dhe marrjen e aftësive si një prej vështirësive kryesore në vitin 2008. Numri më i lartë i bizneseve që raportonin këto vështirësi gjendeshin në grupimin e vendeve me të ardhura të mesme të zonës CIS, ku më shumë se 40 përqind e firmave ishin të pakënaqura nga pagjindshmëria e punëtorëve të aftë. Një masë më e vogël në vendet e Ballkanit Perëndimor raportuan nivele të ngjashme pakënaqësie, me një variabël domethënëse në nivelet e pakënaqësisë krahasuar me vendet e EU10+1 (Bashkimit Evropian 10 + 1) dhe Turqisë (të dhënat e BEEPS-it 2008). Edhe pse recensionin mund të ketë prodhuar një farë shtyrje të këtyre mungesave, me rikuperimin e ekonomive në rajon, kërkesa për punë do të ngushtohet sërish dhe mangësitë në krahun e aftë të punës ka gjasa të jenë më të mëdha se më parë.

**Figura O.2 Shpërndarja e Bizneseve në Rajonin ECA, të cilat e konsiderojnë mungesën e punëtorëve me aftësi si një pengesë “Madhore” apo “Tejet të rëndë, 2008**



*Burimi:* Përlogaritjet e Autorit bazuar në BEEPS 2008.

*Shënim:* LI = Të Ardhura të Ulëta, MI = Të Ardhura të Mesme,  $x = \%$  e firmave (në vendet respektive) që e konsiderojnë arsimin një pengesë. Figura përfaqëson të dhëna të marra nga rrethi i katërt i BEEPS i kryer në 2008–2009, i cili mbulonte rreth 11,800 sipërmarrje në 29 vende.

Konsulto “Shkurtimet” për kodet e vendeve.

## Pse janë aftësitë një problem emergjent nëse sistemet arsimore funksionojnë?

Paçka niveleve të regjistrimeve dhe përfundimeve përgjithësisht të larta, si dhe arsimit cilësor (i matur në klasat fillore) bazuar në nivelin e tyre të të ardhurave, rritja ekonomike në vendet e ECA kushtëzohet nga mungesat në aftësi. Kjo është një enigmë e cila nuk mund të zbulohet plotësisht, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit thelbësor. Thënë më thjeshtë, nuk ekziston informacion që mund të krahasohet me të njëjtin indikator ndërkombëtar për sa i përket pjesë së dytë të arsimit dytësor apo atij terciar apo mbi relevancën e arsimit në këto nivele—informacion që të mund të përcaktonte nëse të diplomuarit kanë aftësitë e duhura për tregun modern të punës.

Ekzistojnë vlerësime ndërkombëtare që ofrojnë informacion mbi kompetencat e studentëve deri në moshën 15 (zakonisht fundi i pjesës së parë të arsimit sekondar), por kjo nuk është moshë kur shumica e individëve në rajon hyjnë në tregun e punës. Përtej këtyre vlerësimeve fillestare, nuk ekziston informacion gjithëpërfshirës dhe tërësisht i besueshëm mbi aftësitë e studentëve. Çka është dhe më e rëndësishme, informacioni mbi kompetencat e studentëve që është i mundshëm tregon vetëm aftësitë në njohuritë thelbësore dhe jo aftësitë në sjellje—përfshirja e çështjeve të tilla si etika në punë dhe puna në grup—të cilave u vihet theksi nga punëdhënësit. Në mënyrë që studiuesit dhe politik-bërësit të mund të kuptojnë shkaqet e këtij ngërçi në zmadhim të aftësive—dhe mënyrat se si mund ta adresojnë këtë problem—kjo mangësi informacioni duhet të plotësohet. Duke pasur parasysh mungesën të dhënave për aftësitë e punëtorëve të rinj, konkluzionet e këtij studimi janë bazuar domosdoshmërisht në të dhënat e arritshme.

Dy janë problemet më akute që lidhen me cilësinë e arsimit në rajonin ECA: shumë prej studentëve nuk përfundojnë dot studimet dhe sistemi arsimor ka vështirësi në dhënien e aftësive në zgjidhjen e problemeve. Për sa i përket numrit të lartë të studentëve që mbesin në klasë, të dhënat e PISA tregojnë se të gjithë vendet ECA (me përjashtim të një grupi shumë të vogël të anëtarëve të rinj të BE) kanë nivele shumë të larta 15 vjeçarësh të cilët kanë aftësi të dobëta numerike dhe letrare dhe si pasojë suksesi i tyre në tregun modern të punës është tejet i pasigurt. Me rritjen e kërkesës në punë edhe për këtë grup, mangësitë e tyre në aftësi do bëhen gjithnjë e më të dukshme. Edhe pse vendet ECA performojnë mirë në vlerësimet që matin studentët në nivelet e para arsimore (klasa e 4t), performanca e tyre është më e dobët për studentët në nivelin e parë të arsimit sekondar (klasa e 8t). Këto rezultate të lënë të kuptosh se sistemet arsimore në këto vende janë të përshtatshëm në dhënien e aftësive bazë, por kanë probleme në tejçimin e aftësive më të avancuara si zgjidhja e problemeve —aftësitë kryesore që kërkohen nga bizneset.

Më shqetësues është fakti se cilësia e arsimit në rajonin ECA gjithashtu nuk tregon shenja konsistente përmirësimi. Në fakt, deri në vitin 2006 dukej se ky aspekt po përkeqësohej në shumë prej këtyre vendeve. Në vend që të ngushtohej diferenca me mesataren e pikëve të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), shumë prej vendeve ECA që marrin pjesë në vlerësimet ndërkombëtare të mësimdhënies në këtë nivel—të cilët me shumë janë sistemet më të mirë menaxhuar—ose kanë mbetur në vend ose janë përkeqësuar në nivelin e pikëve që marrin. Për më tepër është e mundur që në vendet jo pjesëmarrëse në këto vlerësime, situata e arsimit është edhe më keq. Gjithsesi është inkurajues fakti se në raundin e fundit të PISA (2009) 11 prej vendeve ECA treguan përmirësim në performancën e tyre në krahasim me 2006 duke lënë të kuptohet se ndoshta kjo është një pikë kthese (me rritje të konsiderueshme për Bullgarinë, Rumaninë, Serbinë, Republikën e Krigizit dhe Turqinë). Por gjithashtu shtatë prej vendeve ECA vazhduan rënien e mëtejme të konstatuar dhe më parë, me një përkeqësim në krahasim me performancën e tyre më 2006.

Cilësia e arsimit të nivelit të dytë sekondar dhe atij terciar në rajon ka pak gjasa për përmirësim, edhe pse mungesa e të dhënave e bën të vështirë konfirmimin e këtij fakti. Duke qenë se cilësia e edukimit nuk tregon përmirësim të vazhdueshëm në nivelin e parë të arsimit sekondar, ka gjasa që kjo dobësi të përcillet dhe në nivelin e dytë të kësaj shkalle (megjithëse me një vonesë). Regjistrimet në nivelin terciar kanë qenë të kontrolluara në mënyrë më strikte dhe të rezervuara për një numër më të vogël të atyre që kishin rezultatet më të mirë. Sidoqoftë në dy dekadat e fundit, regjistrimet në këtë nivel janë dyfishuar, trefishuar, apo dhe katërfishuar, por pa benefitin

e mekanizmave të nevojshme që sigurojnë cilësinë për shumë prej programeve, institucioneve dhe tipave të rinj të studentëve, dhe në mungesë të informacionit të nevojshëm për prindër e student në mënyrë që këta të fundit të bëjnë zgjedhjen e duhur. Si pasojë është e paqartë nëse zgjerimi i sistemit është shoqëruar nga rritja e kualitetit.

Ka gjithashtu mundësi që të diplomuarit e nivelit të dytë sekondar dhe atij terciar janë duke përfunduar studimet me përfitim të aftësive të gabuara. Gjatë viteve të para të tranzicionit, sistemi i arsimit profesional—i cili dikur nxirrte më shume se gjysmën e të diplomuarve në arsimin sekondar në shumë prej vendeve ECA—kolapsi shumë shpejt. Duke zgjedhur me këmbët e tyre, studentët e kanë braktisur sistemin profesional në favor të arsimit të përgjithshëm sekondar dhe perspektivës së vazhdimit të nivelit terciar. Ka mundësi që lavjersi të jetë drejtuar më shumë drejt një kahu, dhe sic pohohet dhe nga punëdhënësit është vështirë të gjesh të diplomuar me aftësi teknike. Gjithsesi, deri sa të mbahet një reformë për përmirësimin e sektorit të arsimit profesional duke siguruar se studentët do të marrin aftësitë e duhura, është ende herët për të inkurajuar rikthimin e studentëve në këtë sektor.

Kontributi i arsimit në mangësitë në aftësi nuk lidhet vetëm me paqartësitë në cilësi dhe rëndësi të edukimit formal. Mungesa e opsioneve për trajnim të mëtejshëm të punëtorëve është gjithashtu një faktor që duhet përfshirë. Gjithnjë e më shumë evidencë tregon se arsimit dhe trajnimi i vazhdueshëm i të rriturve ndihmojnë në punësim dhe rritjen e produktivitetit. Zhvillimi i këtij sektori duhet të ndodhë sipas axhendës qendrore të zhvillimit ekonomik të rajonit, veçanërisht në vendet më të avancuara të ECA dhe në vendet ku po haset një rënie domethënëse demografike—një rënie që të lehtë kuptosh që pjesëmarrja në krahun e punës dhe produktiviteti individual duhet të rriten në mënyrë që të ketë nivele më të larta të rritjes ekonomike. Sidoqoftë shumë prej këtyre vendeve sapo kanë filluar të përgatiten për një zgjerim të sektorit të trajnimit për të rritur, i nevojshëm për të konkurruar vetëm në ekonominë globale, por gjithashtu dhe për të adresuar vonesat e rezultateve që prej tranzicionit në ekonominë e tregut. Për sa kohë që ka një rritje të kërkesës për punëtorë më të aftë, trajnimi dhe edukimi i të rriturve nuk duhet të injorohet në vendet ECA.


## **Fushat prioritare për veprim**

Siç u konstatua dhe në fillim, ka tre pengesa kryesore që ndalojnë krijimin një sistemi arsimor fleksibël dhe përgjegjës në rajonin ECA. Së pari, këto sisteme kanë operuar “në errësirë” duke qenë se planifikojnë politika dhe marrin vendime menaxheriale pa mbledhur dhe analizuar sistematikisht të dhënat mbi rezultatet e shkollimit dhe punësimit të studentëve dhe të diplomuarve. Së dyti, trashëgimia e sistemit të centralizuar ka ruajtur një menaxhim tejet të qendëruar të sistemit shkollor, me përfshirje intensive të politik-bërësve qendror në detaje operacionale. Ndërkohë që virtualisht të gjithë vendet e OECD kanë përqafuar teknikën e menaxhimit të orientuar nga performanca në arsim që prej viteve 1980 (shih OECD 2004)—edhe pse me ritme të ndryshme—shumë prej vendeve ECA vazhdojnë të përdorin praktikatat menaxheriale që fokusohen tek përmbushja e rregullave të detajuar dhe skemave financiare që bazohen në inputet, dhe jo në rezultate. Kjo do të thotë se shumë prej autoriteteve arsimore dhe drejtorive të shkollave u mungon autonomia dhe autoriteti për të kryer vendime thelbësore menaxheriale për institucionet e tyre, duke përfshirë këtu sa dhe cilën përmbajtje profesionale

për studentët mund të zgjedhin dhe sa mësues të punësojnë. Si pasojë sistemi është jo-fleksibël dhe nuk i përgjigjet as kërkesave të tregut të punës as ndryshimit të numrit të studentëve.

Së treti, sistemet arsimore në vendet ECA përdorin në mënyrë tejet jo-efikase burimet financiare. Askund nuk është ky fakt më i qartë, sesa në sektorin para-universitar, ku pak vende e kanë rregulluar nivelin e mësuesve të punësuar përkundrejt numrit të studentëve që ngelin në klasë gjatë 20 viteve të fundit. Si pasojë, niveli student-pedagog ka rënë ndjeshëm (dhe kostot për student janë rritur)—më shumë se për çdo rajon tjetër të botës (shih figurën O.3). Kjo do të thotë se burimet e pakëta mbeten për të paguar rrogat e ulëta të shumë mësuesve dhe për të ngrohur godina gjysmë boshe.

**Figura O3. Raporti nxënës - mësues në rajonin ECA krahasuar me rajone të tjera në 1990–2008**



*Burimi:* Baza e të dhënave EdStats, plus përlllogaritja lineare e autorit për vitet ku mungojnë të dhënat.

*Shënim:* Të dhënat faktike janë shënuar me pika. Një nga problemet kryesore me të dhënat ndërkombëtare për raportin nxënës-mësues (si në databazën EdStats të Bankës Botërore ashtu dhe në databaza të tjera ndërkombëtare për arsimin) është se ka paqartësi mbi faktin nëse të dhënat për një vend të veçantë raportohen në bazë të një ekuivalenti me kohë të plotë.

Për të qenë të drejtë, këto pengesa ndikojnë në mënyra të ndryshme vendet ECA dhe variojnë sipas nivelit të arsimit. Gjithsesi, asnjë prej vendeve ECA nuk ka mundur ti shpëtojë plotësisht trashëgimisë të planifikimit të centralizuar.<sup>4</sup> Ky sistem fokusohet në kontrollin e inputeve—çka do të thotë se kontrollon nëse aktorët lokal janë në akord të të gjithë normave të detajuara për të

gjithë inputet. Gjithsesi ministrinë e arsimit mbeteshin të painformuara për kompetencat dhe aftësitë që përftoheshin nga studentët.

Në kuadër të faktit sa shumë këto pengesa ndihen në nivelet e ndryshme të arsimit, ato mbeten më të ndjeshme në nivelin parauniversitar, i cili thith dy të tretat e totalit të shpenzimeve për arsimin në rajonin ECA. Këto tri pengesa ndikojnë disi më ndryshe arsimin terciar, duke qenë se ky sektor i është nënshtruar reformave thelbësore gjatë këtyre 20 viteve të fundit, kohë gjatë së cilës sektori është dyfishuar apo trefishuar në shumë vende (shih kapitullin 5). Duke qenë se shumë vende ECA ende nuk kanë sektorë të arsimit për të rritur të standardeve moderne, këto pengesa nuk mund të karakterizohen si probleme të këtij sektori. Gjithsesi, rekomandimet për sa i përket politikave që ofrohen në këtë studim janë të vlefshme dhe për arsimin për të rritur dhe mundësojnë ide dhe principe se si ky nën-sektor mund të zhvillohet dhe menaxhohet në rajon (shih kapitullin 6).

## **Menaxhimi i sistemit arsimor për rezultate**

Për të adresuar tri pengesat e shprehura më sipër vendet e rajonit ECA duhet të menaxhojnë sistemin e tyre arsimor në mënyrë që të gjenerojnë rezultate. Së pari dhe mbi të gjitha, ato duhet të mbledhin më shumë informacion për sa i përket performancës, çka do të thotë informacion mbi çfarë po mësojnë studentët, çfarë punësh po mund të gjejnë ata, dhe çfarë rrogash po përfitojnë të diplomuarit. Për më tepër, vendet e ECA mund të përfitojnë duke ndjekur rrugën e vendeve të OECD apo disa vendeve të tjera në zhvillim duke zëvendësuar menaxhimin e orientuar nga inputet në sektorin e arsimit me menaxhim të orientuar nga performanca e këtij sektori. Ky ndryshim përfshin zhvillimin e autonomisë për organet lokale dhe ofruesit e parë dhe vendosjen e mekanizmave të llogaridhënies—si për shembull, në formën e kontratave të performancës dhe buxhetimit të bazuar në performancë— të cilët vendosin theksin tek performanca e jo tek plotësimi i normave. Me mundësimin e më shumë të dhënave për sa i përket performancës dhe me fuqizimin e ofruesve të parë me më shumë vendim-marrje, do të vendosen parakushte për një sistem rajonal arsimor më të efektshëm dhe që i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës.


### ***Fokusim drejt Rezultateve të Mësimdhënies dhe Punësimit***

Vende në rajonin ECA do të përfitonin më shumë nëse do të matnin më mirë rezultatet e shkollimit dhe punësimit, informacion që mund të përdoret prej tyre për të planifikuar politika më të mira në sektorin e arsimit. Ekziston një konsensus domethënës mbi aftësitë dhe kompetencat kryesore që arsimi pritet të ofrojë, si dhe teste të standardizuara për ti matur ato.<sup>5</sup> Shumë vende në rajon janë tashmë pjesë e vlerësimeve ndërkombëtare, por kanë një vepruar më ngadalë se vendet e tjera pjesëmarrëse për të gjeneruar informacion dobishëm nga vlerësimet kombëtare. Edhe pse gjithë sistemet shkollore të rajonit kanë një mënyrë vlerësimi për sistemin kombëtar, shumë prej tyre janë në hapat e para të zhvillimit (shih figurën O.4) dhe ekziston shumë pak evidencë deri më tash mbi vendet ECA që po i përdorin këto vlerësime në favor të politikë-bërjes. Vlerësimet kombëtare shihen ende si mekanizma certifikimi që konfirmojnë nëse studenti ka marrë diturinë e përcaktuar në kurikula, duke ofruar kështu një diplomë apo vazhdimin e mëtejshëm të arsimit në nivelin e dytë sekondar apo atë terciar. Vlerësimet e

studentëve rrallë herë shihen si një mundësi për të përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë e një sistemi arsimor.

Pasi studentët diplomohen, ministrinë e arsimit në rajonin ECA nuk mbledhin më informacione sistematike për të analizuar dhe shpërndarë rezultatet e tyre në punësim. Ky informacion është kyç për politik-bërësit dhe institutet e arsimit të lartë duke qenë se ndihmon në përcaktimin e fushave dhe programeve studimore që janë shumë të kërkuar nga punëdhënësit. Për më tepër, këto të dhëna mund të ndihmojnë studentët për të kryer zgjedhje më të efektshme të universiteteve apo fushave të studimit që duan të ndjekin. Është për t'u përsëritur fakti që disa prej vendeve të OECD (përfshi këtu Hungarinë, Italinë dhe Vendet e Ulëta), sëbashku me Rumaninë, përbëjnë një shembull i mirë për tu ndjekur në këtë aspekt.

**Figura O.4 Statusi i matjes dhe përdorimit të të dhënave mbi rezultatet e shkollimit të studentëve në Rajonin ECA, 2009**



*Burimet:* Vlerësimi i autorëve bazuar në të dhënat e UNICEF (2007, tabela 2.1); masa e pjesëmarrjes së vendeve në PISA, (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve), PIRLS dhe TIMSS që prej 1995; dhe inpute nga ekspertët vendor të Bankës Botërore.

Të dhënat e UNICEF janë nxjerrë nga “Tabela 2.1: Statusi i Reformës në Sistemet e Vlerësimit dhe Testimit, 2006,” për sa i përket “Prezantimit të provimeve dhe vlerësimeve të tjera për shkollat (p.sh. shkollimi bazë)” dhe “Prezantimit të vlerësimeve kombëtare në bazë të kampionëve”. Në këtë tabelë, UNICEF vlerëson me pikë progresin e vendeve në një nivel nga 0 në 4, ku 0 përfaqëson “e paplanifikuar/e pafilluar” dhe 4 përfaqëson “në gjendje operative”. Për më tepër, figura përdor përpilime të stafit të Bankës Botërore mbi numrin e vlerësimeve ndërkombëtare në të cilat kanë marrë pjesë secili prej vendeve.

### ***Prezantimi i Autonomisë dhe Llogaridhënies Bazuar tek Rezultatet***

Tejkalimi i trashëgimisë së planifikimit të centralizuar ka të bëjë me braktisjen e normave të detajuara dhe në vend të saj rritjen e llogaridhënies të aktorëve në bazë të *performancës* (apo

rezultateve). Në nivel qendror, kjo nënkupton se politik-bërësit e rajonit ECA duhet të heqin dorë nga disa detyra dhe të marrin përsipër disa të tjera në mënyrë që sistemet arsimore të mund të zhvillojnë dhe përmirësojnë rezultatet e shkollimit të studentëve. Oportuniteti për qeveritë qendrore në këto vende është që të largohen prej menaxhimit të shkollave dhe klasave dhe në vend të kësaj të fokusohen drejt caktimit të objektivave, politikave, dhe standardeve; përcaktimit të përgjegjësive; mobilizimin e burimeve financiare; sigurimin e konsensusit politik; përfshirjes dhe fokusimit ndaj studentëve të varfër dhe atyre të marginalizuar; dhe monitorimin dhe vlerësimin e ofertës së shërbimit dhe cilësisë së sistemit.

Shtimi i autonomisë për sistemet e arsimit do të thotë vendosje e autoritetit dhe përgjegjësisë në duart e njerëzve më të aftë për të zhvilluar dhe përmirësuar cilësinë e arsimit: menaxherët lokal dhe autoritetet e arsimit (shih Osborne dhe Gaebler 1992). Kjo do të thotë gjithashtu që këta aktorë janë përgjegjës për përmirësimin e rezultateve në shkollimin e studentëve të tyre. Përputhja e incentivave të këtyre palëve me rezultatet e kërkuara të shkollimit të studentëve kërkon që ministritë e arsimit të vendosin objektivat e përgjithshme për performancën; të përcaktojnë kush është i përgjegjshëm ndaj kujt dhe për çfarë; dhe për të siguruar që këto përgjegjësi janë pranuar dhe kuptuar nga të gjithë.

Në nivelin para-universitar, politikbërësit mund të zgjerojnë autonominë e aktorëve të niveleve të ulëta në sistemin shkollor duke u mundësuar këtyre të fundit fuqi më të madhe në vendim-marrje, fuqi mbi veprimtaritë e shkollës dhe buxhetin, dhe zbutjen e normave për sa i përket madhësive të klasave. Autonomi më e madhe gjithashtu kërkohet dhe në arsimin profesional dhe në trajnim, ku programet dhe institutet duhet të kenë mundësinë për t'u zgjeruar apo për të kontraktuar oferta të ndryshme kursesh në përgjigje të kërkesave nga studentët dhe punëdhënësit, dhe në kuadër të normave strikte të qeverisë.

Në të njëjtën kohë, politikbërësit duhet të implementojnë një sërë mekanizmesh për menaxhimin e llogaridhënies në mënyrë që shkollat të jenë përgjegjëse për rezultatet. Mekanizmat potencial përfshijnë krijimin e këshillave të shkollës që përbëhen nga prindër dhe anëtar të komunitetit lokal në proceset vendim-marrëse të shkollës; t'u kërkohet shkollave që të përgatisin planet e zhvillimit të shkollës që përcaktojnë pikat e forta dhe dobësitë e secilës shkollë dhe planin e veprimit për përmirësime; përgatitja e 'tabelave të vlerësimit' që përfshijnë indikatorët bazik për performancën e shkollës; si dhe sanksionimin e shkollave që performojnë dobët dhe shpërblimin e atyre që performojnë mirë. Këtu, gjithsesi, është e rëndësishme që të përcaktohet një shkollë që performon mirë si një shkollë që ofron rezultate të përmirësuara në mësimdhënie për të gjithë tipet e studentëve, duke përfshirë dhe ata që vijnë nga familje të varfra apo minoritete.

Gjithsesi do të jetë e vështirë që të arrihen përmirësime domethënëse në sistemin shkollor për aq kohë sa politik-bërësit e rajonit nuk adresojnë decentralizimin e punonjësve në mësimdhënie, një përpjekje që do të përfshijë zgjidhjen e problemit serioz të mbipunësimit dhe përmirësimin e pagës, zhvillimin profesional, dhe kushteve të punës për mësuesit.

Në nivelin terciar, si shtimi i autonomisë ashtu dhe rritja e llogaridhënies janë njëlloj të rëndësishme. Pjesa e parë e këtij ekuacioni është plotësuar tashmë në një numër vendesh të rajonit—përgjithësisht anëtarët e rinj të BE, dhe disi më pak vendet e Evropës Juglindore, Rusia, dhe Ukraina—të cilët i kanë lejuar autonomi të konsiderueshme ofruesve terciar. Këto vende,

edhe pse vazhdojnë të kenë progres në shpërndarjen e autoritetit menaxherial, duhet të përballen tani me sfidën kryesore (por jo ekskluzive) të përmirësimit të integritetit akademik dhe fiskal të sektorit duke prezantuar mekanizma më të fortë për mbajtjen e llogaridhënies. Vende të tjera të rajonit, veçanërisht Bjellorusia dhe shumë prej vendeve me të ardhura të vogla të zonës CIS, duhet ende të përballen me mënyrën se si menaxhohen sistemet e tyre terciare. Këto vende përballen me sfida të një-pas-njëshme në krijimin një autonomie më të zgjeruar të universiteteve ndërkohë që zhvillojnë mekanizma për mbajtjen e llogaridhënies dhe prezantojnë skema financimi të bazuara në performancë. Për sa i përket nevojës për të monitoruar dhe vlerësuar ofertën dhe kualitetin e sistemit, të gjitha vendet e rajonit mbeten pas; me fjalë të tjera, të gjithë vendet duhet të marrin hapa më serioz për të “hedhur dritë” dhe përmirësuar mbledhjen e të dhënave për sa i përket shkollimit të studentëve dhe rezultateve në arsim.

Edhe pse ende ekzistojnë në masë probleme thelbësorë të integritetit në sektorin universitar, është e rëndësishme që politik-bërësit në rajonin ECA të mos-shpejtohen në zgjidhjen e këtyre problemeve pa shpërndarë *më parë* më shumë autoritet për universitetet dhe pa prezantuar skema fleksibël financimi. Grupi i vendeve ECA që ende nuk kanë nisur reformat për sistemin terciar duhet të prezantojnë si autonominë ashtu dhe përgjegjësi-mbajtjen si instrumente politike njëlloj të rëndësishme për forcimin e këtij sektori. Politik-bërësit e këtyre vendeve duhet që jo vetëm të transferojnë më shumë autonomi ndaj universiteteve statike dhe tradicionale por të shoqërojnë shtimin e autonomisë me një reformë menaxhimi dhe lidërshiptit më pranë ‘sjelljes së biznesit’ dhe llogaridhënies.

Duke parë kapacitetin relativisht të dobët institucional të rajonit—përfshi këtu dhe agjencitë e vendosura rishtazi apo in-ekzistente për sigurimin e cilësisë—politikbërësit duhet të venë në punë shumë mjete të ndryshme dhe komplementare për të forcuar mbajtjen e përgjegjësive me efektivitet. Në këto metoda përfshihen renditja, studimeve kërkimore, dhe krijimin e një ambienti favorizues për rritjen e sektorit privat. Vartësi nga një agjenci për kontrollin e cilësisë për të vendosur kapacitetin e nevojshëm për monitorimin e jashtëm të një sektori me rritje të shpejtë është e rrezikshme—një agjenci e tillë duhet të jetë pjesë e zgjidhjes, jo vetëm një përgjigje.

### ***Përmirësimi i Efikasitetit në Përdorimin e Burimeve përmes Financimit të Bazuar në Performancë***

Menaxhimi i efektshëm i sistemeve shkollore do të thotë ndryshim të buxheteve in-fleksibël të bazuar në zëra strikt drejt përdorimit më të madh të buxheteve të deleguar, me incentivat për rruajtjen e regjistrimeve dhe pjesëmarrjes (p.sh., financim për student—një rrugë e marrë tashmë nga shumë prej vendeve të ECA). Financimi më fleksibël dhe inteligjent në formën e financimeve në bllok (p.sh., të bazuar në kontratë- apo performancë) mund gjithashtu të ofroj financime për institucionet që arrijnë rezultatet e caktuara në mësimdhënie. Ky lloj financimi jo vetëm që u jep menaxherëve lokal më shumë fleksibilitet në krahasim me buxhetet e bazuara në inpute, por i mban ata gjithashtu të fokusuar në rezultatet e studentëve.

Përtej financimit të bazuar në performancë, përmirësimi i efikasitetit financiar në nivelin para universitar do të kërkojë krijimin e incentivave për zgjerimin e klasave, inkurajimin e përmirësimit të kushteve në shkolla, dhe adresimin e çështjes së tej-punësimit në mësimdhënie. Në nivelin terciar, disa prej vendeve të ECA (për shembull, Polonia dhe Rumania) kanë filluar

tashmë adoptimin e metodës së financimit për student, duke e zhvendosur fokusin e tyre prej inputeve dhe drejt rezultateve. Pjesa e mbetur e vendeve të rajonit duhet të prezantojnë skema financimi të bazuara në performancë për të përmirësuar efikasitetin e shpenzimeve në këtë sektor.

Nëse vendet ECA duan që njëkohësisht të rrisin nivelin e pjesëmarrjes dhe kualitetin e arsimit terciar, do të ketë nevojë për më shumë burime private—presionet si pasojë e kostove që përballet arsimit i lartë në rajon janë shumë të larta. Mobilizimi i burimeve private do të ndihmojë në forcimin e objektivave të orientuara në bazë të rezultateve në sektorin terciar në dy mënyra thelbësore: (1) duke shtuar konkurrencën, duke qenë se më shumë ofrues privat të mprehtë dhe inovativ ndihmojnë në shtimin e risive dhe për shërbimin publik, dhe (2) duke shtuar lidhjet e studentëve me proceset arsimore. Kur studentët dhe prindërit paguajnë tarifën e shkollimit—si në shërbimin publik ashtu dhe në atë privat—ata janë përgjithësisht më kërkues për sa i përket kualitetit dhe rëndësisë së arsimit të ofruar. Nuk ekziston një nivel i vetëm ideal për financimet në arsimin e lartë, dhe gjithashtu asnjë përzjerje ideale të financimeve publike dhe privat. Vendeve të ndryshme do t'u duhet të bëjnë rregullime të ndryshme sipas konditave.

## **Ndërtimi i Bazave për Sistemin e Mësimdhënies për të Rritur**

Ndryshe nga sistemi para-universitar dhe ai universitar, sistemet e arsimit për të rritur janë në masë in-ekzistent në shumë prej vendeve ECA. Ndërtimi i sistemeve të tilla do të kërkojë zhvendosjen nga programet e caktuara prej qeverisë drejt tregjeve të mirë-rregulluar të ofruesve privat dhe publik që mundësojnë shërbime trajnimi si për të rriturit e punësuar ashtu dhe për ata të papunë. Qeveritë në rajon do vazhdojnë, gjithsesi, të luajnë një rol në arsimin dhe trajnimin e të papunëve, shpesh duke kontraktuar ofrues privat për të mundësuar shërbimet e kërkuara. Politikat që adresojnë dështimet e tregut në këtë sektor janë veçanërisht të rëndësishme për vendosjen e themeleve për një sistem të efektshëm arsimor për të rritur. Në përgjithësi, sistemet e suksesshme kërkojnë një nivel të lartë koordinimi dhe partneriteti midis agjencive qeveritare dhe sektorit privat, si dhe për t'u dhënë krahut të kërkesës në trajnime—pra bizneset dhe individët—një zë të fuqishëm në përcaktimin e politikave për trajnimet. Njëherë që një sektor solid i arsimit për të rritur është vendosur, qeveritë mund ta drejtojnë atë duke monitoruar të dhënat mbi cilësinë e programeve, duke promovuar autonominë në shkëmbim për llogaridhënies, dhe duke përmirësuar efikasitetin e financimeve qeveritare në këtë sektor.

Zgjerimi i mësimdhënies tek të rriturit është një prioritet për ekonominë e zhvilluar në rajon të cilat po përballen me ulje demografike. Sfidat e tyre qëndron në sigurimin e funksionimit për mekanizmat aktual të koordinimit dhe që legjislacioni dhe financimet të përdoren për të lehtësuar zhvillimin e një sektori të arsimit për të rritur të orientuar nga interesat private dhe tregjet e trajnimeve. Prioritet parësor i ekonomive më pak të avancuara në rajon të cilat gjithashtu po përballen me një rrënjë demografike (p.sh. shumë prej vendeve në Evropën Juglindore dhe vendeve me të ardhura të mesme të zonës CIS) është prezantimi i një kuadri politikash për arsimin tek të rriturit dhe krijimin e mjeteve të nevojshme për të implementuar këtë strategji (p.sh. mekanizmat koordinues, plus hapat fillestar të legjislacionit). Për ekonomi më pak të avancuara në rajon të cilat nuk përballen me rënie demografike (p.sh., ato vende të zonës CIS me të ardhura të pakëta dhe Shqipëria), do të ishte më produktive të kufizoheshin përpjekjet për të

vendosur një kuadër politikash dhe mekanizmash koordinues për këtë sektor. Për shumë vende që janë pjesë e Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Kompetencave tek të Rriturit (PIAAC) do të ishte një hap i parë me rëndësi të kuptonin aftësitë dhe kompetencat aktuale të forcës së tyre punëtore.

## **Konkluzione**

Do të duhet kohë për të zhvendosur sistemet arsimore në rajonin ECA larg prej fokusit ndaj inpleteve dhe drejt fokusimit ndaj ofrimit të një arsimit cilësor pr shumicën e studentëve. Pritja e mëtjshme për të filluar këtë proces do të shkaktojë vetëm mbetjen pas të këtyre vendeve për sa i përket aftësive që ekonomitë e tyre ofrojnë dhe që janë të nevojshme për të konkurruar në ekonominë globale. Mbi të gjitha, nevojitet një matje më e lartë e rezultateve të studentëve në të gjithë nivelet e sistemit arsimor në mënyrë që politik-bërësit të mund të kuptojnë pikat e forta dhe dobësitë e secilit prej sistemeve të tyre respektive dhe në mënyrë që të hartojnë politika efektive për t'i përmirësuar këto sisteme. Nëse roli i qeverisë qendrore do të ri-përcaktohej vetëm tek fokusimi ndaj politikave strategjike, objektivave të sistemit, dhe legjislacionit, politik-bërësit qendror do të ishin të lirshëm për të përdorur incentivat për të menaxhuar aktorët e niveleve të ulëta në mënyrë që të arrinin objektivat dhe më pas të matnin rezultatet.

Në shkolla, ky proces do të përfshijë përdorimin e më shumë financimeve për kokë, më shumë autonomi, dhe më shumë llogaridhënie për rezultatet e mësimdhënies. Në nivelin e arsimit të lartë është i nevojshëm fuqizimi i mekanizmave kombëtar që sigurojnë cilësi në mënyrë që të përmirësohet llogaridhënia e ofruesve të arsimit, siç është shpërndarja e më shumë informacioneve për sa i përket rezultateve të procesit të nxënies dhe punësimit (p.sh., rezultatet e studimeve kërkimore, apo renditjes së universiteteve) në mënyrë që studentët të marrin një vendim sa më të mirë informuar. Për më tepër, incentivat ekzistuese të financimit do të duhet të fuqizohen përmes prezantimit të politikave buxhetore bazuar në performancë dhe, aty ku është e mundur, të shtohet autonomia institucionale. Edhe pse sistemet e arsimit për të rritur janë tejet të rëndësishëm për rajonin, prioriteti i tyre në vende të caktuara të ECA do të varet nga konditat ekonomike dhe demografike të vendit apo dhe nga sektorë të tjerë të arsimit me nevojë më të menjëhershme për veprim. Gjithsesi të gjithë vendet e rajonit mund të nisin hapat për të zhvilluar një strategji koherente të arsimit dhe trajnimit për të rritur.

## Shënime

1. Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore përfshin: Shqipërinë, Armeninë, Azerbajxhanin, Bjellorusinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Estoninë, Gjergjinë, Hungarinë, Kazakistanin, Kosovën, Republikën Kyrzyze, Latvian, Lituaninë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Moldavinë, Malin e Zi, Poloninë, Rumaninë, Federatën Ruse, Serbinë, Republikën Sllovaqe, Tashikistanin, Turqinë, Turkmenistanin, Ukrainën dhe Uzbekistanin.
2. E përshtatur për Paritetin e Fuqisë Blerëse, apo PPP.
3. Studimi i BERZH-Bankës Botërore për Klimën e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve (BEEPS) mundëson të dhëna konstante për vështirësitë e vetë-raportuara nga bizneset në rajonin ECA për sa i përket zgjerimit të tyre ekonomik. Sondazhet janë kryer në të gjitha vendet e ECA në vitet 1999, 2002, 2005, dhe 2008. Kampionët e sondazheve ndërtohen përmes përzgjedhjes të rastësishme nga regjistri kombëtar i firmave (apo dokumenteve ekuivalente) dhe mbulon si sektorin e shërbimit ashtu dhe atë të industrisë.
4. Duhet pasur parasysh që Turqia nuk ka një të shkuar socialiste, por vepron përgjithësisht ‘në errësirë’ dhe nuk ka kryer reformat menaxheriale të orientuara drejt performancës si vendet e tjera të OECD. Çështjet e efikasitetit të shpenzimeve janë gjithsesi të një natyre të ndryshme. Shih Banka Botërore 2005a.
5. Ndërkohë që përdorimi i vlerësimeve të mësimdhënies nuk është i diskutueshëm, metodat e testimit janë përmirësuar në vitet e fundit, duke i bërë këto teste më të mirë dhe më të vlefshëm në vlerësimin e shkollimit të studentëve në krahasim me të kaluarën.